



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org. Jedinica Org. Unit	ARPL
Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages	04
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	279-2/24
Data: Datum: Date:	11.04.24
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	04.04.2024
REFERENC-Ë:	279/24 - ZSP- ARPL/ 2024
PËR/ZA/TO:	N.T.SH. „PISTA EKOPLAST”, Zona Industriale Rahovec p.n. R204, K. Rahovec
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH	Z. Izedin BYTYQI, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së Z. Naser AFIZI, Zëvendësues i drejtorit të ARPL- së Znj. Makfirete DIBRANI, Udhëheqëse e DMRU-së
NGA/OD/FROM:	Myvedete MUJA, Zyrtare e Lartë për të drejtën ujore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim - Leje Ujore, Shkarkim

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin tekniko-investigativ, për shkarkim të ujit, me Nr. të protokollit: 279/24, parashtruar nga N.T.SH „PISTA EKOPLAST”, datë 18.01.2024, si dhe dok . shtesë , me nr protok 279-2/24 , datë 28.03.2024, Zona Industriale Rahovec p.n. R204, K. Rahovec, dhe ka vendosur si në Vendim për Leje Ujore, të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

L.U.

Datë: 04.04.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjenive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, shtojcës 1 pika 10 të Rregullorës (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L-147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitive ligjore të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa e palës N.T.SH., „PISTA EKOPLAST ” K. Rahovec, për **LEJE UJORE**, për shkarkimin e ujërave të ndotura nga fabrika e prodhimit dhe riciklimit të plastikës me nr protokoli 279/24, datë 18.01.2024, K. Rahovec; P-71510057-05068-2 & P-71510057-05068-3; Impianti me koordinata: (X=7 472 937; Y=4 695 583), sipas kushteve vijuese:

1. Leja Ujore lëshohet në bazë të dokumentacionit tekniko - investiv për shkarkimin e ujërave nga impianti për paratrajtim, pastaj në kanalizimin publik të qytetit të Rahovecit
2. Afati i lëshimit të lejes ujore është 5 (pesë) vite, me mundësi zgjatjeje sipas kërkesës së palës;
3. Analiza dhe përcaktimi i parametrave standard e projektues, kualitativ dhe kuantitativ (temperatura, pH, SHBO₅, SHKO, sasia materieve të suspenduara, baktereve e ngjashëm) të përcaktuar me legjislacionin në fuqi, paratrajtimi për specifikat e recipientit, duhet prezantuar në MMPHI;

4. Objektet me destinim të grumbullimit, trajtimit të ujërave të ndotur dhe llumit dhe ato të shkarkimit, duhet të mirëmbahen rregullisht dhe të shfrytëzohen në atë mënyrë që të sigurojnë funksionalitet të plotë;
5. Nëse gjatë operimit vije deri të ndryshimi i regjimit të ujërave dhe shkaktimit të dëmeve eventuale mjedisit, ose palëve të treta, investitori është i obliguar që dëmet t'i evitohet dhe të njejëtat t'i kompensoj;
6. Që të kryhet monitorimi në të gjitha fazat e trajtimit të efluentit sipas destinimit të veçant, rezultatet e monitorimit të raportohen në MMPHI/ARPL çdo gjashtë muaj;
7. Obligimi financiar lidhur me shkarkimin e ujërave të ndotura, do të caktohet me vendim të posaçëm, në rast se analizat e ujit nuk i plotësojnë kriteret sipas U.A. MMPH -Nr. 02/2022 për kushtet, mënyra, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor”;
8. Të drejtat e fituara në bazë të Lejes Ujore nuk mund t'u barten personave të tretë, pa pajtimin e organit i cili ka lëshuar këtë Leje Ujore;
9. Për vazhdimin e Lejes Ujore bartësi është i obliguar, që të aplikoj se paku 2 (dy) muaj para skadimit të afatit të Lejes Ujore;
10. Validiteti i Lejes Ujore pushon në rast të mos plotësimit të kushteve të lartcekura në afatet e parapara kohore.

ARSYETIM

Zyrtarët përgjegjës, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin e ndërtimit, kanë shqyrtuar dokumentacionin e palës për aplikim: "Dokumentacioni tekniko –investiv për shfrytëzimin e ujit nga prodhimi dhe riciklimi i fabrikes për kompanin N.T.Sh. "PISTA EKOPLAST" – Rahovec; Është konstatuar se uji nuk perdoret në proces teknologjik, por vetëm për ftohje, dhe në mënyre ciklike kthehet prap në përdorim; dokumentacioni i dorëzuar përmban edhe: Certifikata e Regjistrimit të Biznesit (80439896); Certifikata e TVSH-së; Certifikata e pronësisë; Kopje e planit, posedues N.T.Sh. Pista Ekoplast, qirrambajtje 99 vite; Situacioni i terrenit, hartuar, nenshkruar dhe vulosur nga N.P.SH. "GEOMODELING" ;diploma e hartiesit te projektit për shfrytëzim të ujit; Vendim për Leje Mjedisore Nr:17/6079/ZSP/193/18, datë, datë 05.07.2018; Veendim për pëlqim mjedisore; Nr: 10/2777/2-zsp-33/15, datë 16.02.2015; Pëlqim Mjedisor nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit; Pagesat me rastin e aplikimit për shkarkim për (K.U; P.U; L.U) dhe CD-në;

Pala me datë 28.03.2024, ka sjellë dokumentacionin shtesë, ashtu siq iu është kërkuar: Plani i situacionit me përpjesë të lexueshme 1:1000, siq kerkohet me U.Ad. 03/2018 për procedurat për leje ujore, hartuar, nenshkruar dhe vulosur nga person i licencuar i lëmisë përkatëse, gjeodet, nr i licences 34; Kontraten e shërbimit nga K.R.U. "Gjakova" sh.a.; Autorizimin për personin kontakues nga pronari "Pista Ekoplast", Znj. Hana Zeka; Përmirsimi dhe prezantimi i bazës ligjore në fuqi për ujërat. Andaj bazuar në dokuemtacionin teknikoo –investiv të hartuar, dokuemtacionit shtesë të dorëzuar, me datë 28.03.2024 pas takimit për info shtese me palën, shikimit në vend, me datë 29.03.2024 është vendosur si në dispozitiv të këtijë vendimi;

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr: 279/24 -ZSP- 2024, Datë: 04.04.2024

Prishtinë

T'i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Komunës Rahovec;
- Arkivit të Ministrisë.

Zavënedësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së



Izedin BYTYQI